

Ligjërata nga lënda:

Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomacia Moderne

Përmbledhje ligjërata (I):

- Marrëdhëniet Ndërkombëtare (MN) ndikojnë thellësisht mbi jetën e përditshme; të gjithë ne marrim pjesë në MN.
- MN është një fushë e shkencës politike, e përqëndruar kryesisht në shpjegimin e rrjedhjeve politike në çështjet e Sigurimit Ndërkombëtar dhe të Ekonomisë Politike Ndërkombëtare.
- Në shpjegimin e ngjarjeve dhe rrjedhjeve ndërkombëtare teoritë plotësojnë tregimet përshkruese, por studjuesit nuk janë të njëjtit mendim për asnjërën prej teorive ose metodave që përdoren në studimin e MN.
- Në MN shtetet janë aktorët më të rëndësishëm; sistemi ndërkombëtar mbështetet mbi sovranitetin e (reth dyqindë) shteteve territorial të pavarura.
- Shtetet ndryshojnë shumë nga pikëpamja e madhësisë së popullsisë dhe ekonomisë, nga mikroshtetet deri te fuqitë e mëdha.
- Aktorët joshjetëror siç janë korporatat shumëkombëshe, OJQ-të dhe organizatat ndërqeveritare ushtrojnë një ndikim në rritje mbi marrëdhëniet ndërkombëtare.
- Revolucioni në teknologjitë e informacionit, i cili sot po zhvillohet me vrull në të gjithë botën, do të riformësojë thellësisht aftësitë dhe parapëlqimet e aktorëve në MN, në mënyra të tilla që ne nuk i kuptojmë ende.
- Katër nivelet e analizës, niveli individual, shtetëror, ndërshtetëror dhe botëror, ofrojnë shpjegime të shumfishta (që veprojnë njëkohësisht) për rrjedhjet e vëzhguara në MN.
- Niveli botëror i analizës, i cili është shtuar kohët e fundit, tërheq vëmendjen sidomos te ndryshimet teknologjike dhe te mospërputhja botërore në pasuri ndërmjet Veriut të industrializuar dhe Jugut të varfër.
- Gjatë disa shekujve europianët pushtuan një shumëllojshmëri qytetërimesh dhe i përthithën ato në një sistem ndërkombëtar botëror të vetëm, i cili e kishte qendrën fillimisht në Europë.
- Sistemi i fuqive të mëdha përbëhet prej gjashtë ose shtatë shtetesh (anëtarësia e të cilave ndryshon me kohë, meqenëse pushteti shtetëror shtohet dhe pakësohet).
- Fuqitë e mëdha e kanë ristrukturuar rendin botëror nëpërmjet luftërave të vazhdueshme, aleancave dhe sundimit të hegjemonëve (shtetet që fitojnë përkohësisht fuqi më të madhe në sistemin ndërkombëtar). Luftërat më të rëndësishme kanë qenë: Lufta tridhjetëvjeqare (1618-1648) luftë civilizimesh, Luftërat e Napoleonit (1803-1815), Lufta e Parë Botërore (1914-1918) dhe Lufta e Dytë Botërore (1939-1945). Periudhat e hegjemonisë përfshijnë Britaninë në shekullin XIX dhe SHBA-të pas Luftës së Dytë Botërore.
- Shtetet europiane kolonizuan pjesën më të madhe të botës gjatë pesë shekujve të kaluar. Vendet latinoamerikane e fituan pavarësinë menjëherë pas SHBA-së (rreth dyqindë vjetë më parë), kurse ato të Afrikës, Azisë dhe Lindjes së Mesme u bënë shtete të pavarura vetëm në dhjetvjeçarët e Pasluftës së Dytë Botërore.

- Nacionalizmi ndikon shumë mbi MN; konflikti vjen shpesh si rrjedhojë e perceptimeve për kombësinë që të qojnë drejtë kërkesave për shtet ose për ndryshim kufijsh.
- Demokracia është një force që ka rëndësi gjithnjë e më të madhe: shtetet që po qeverisen në mënyrë demokratike po bëhen më të shumtë dhe vendet demokratike e luftojnë rrallë njëri-tjetrin me luftëra.
- Gjatë dy shekujve të kaluar ekonomia botërore ka krijuar pasuri me hap të përshpejtuar dhe po integrohet gjithnjë e më shumë në shkallë botërore, me gjithë pabarazitë shumë të mëdha.
- Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore I dhanë karakterin e tyre shekullit XX, megjithëse ato duket se ofrojnë mësim kontradiktore mbi dobinë e politikave të jashtme të ashpra ose pajtuese.
- Për pjesën më të madhe të pesëdhjetë vjetëve të Pasluftës së Dytë Botërore, politika botërore erdhi rrotull rivalitetit Lindje-Perëndim të Luftës së Ftohtë. Ky qëndrim dipolar krijoi qëndrueshmëri dhe i shmangu lftërat ndërmjet fuqive të mëdha, përfshirë luftën bërthamore, por ai pati rrjedhoja dëmshme për shtetet e botës së tretë që u bënë shesh beteje për interes të tjerëve.
- Periudha e Pasluftës së Ftohtë që filloi në vitet 1990 përmban shpresën e bashkëpunimit të përgjithshëm ndërmjet fuqive të mëdha pavarësisht prej shfaqjes së konflikteve të reja etnike e rajonale.